



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.440/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj-Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuara ankesa Anr.440/2025, e datës 07.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 07 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Istog, ka identifikuar në profilin në instagram, të kandidates për deputete nga lista e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Serbeze Kabashi Muçaj, një video me tekst shoqërues, të realizuar në hapësirat e brendshme të Qendrës Kryesore Familjare në Istog, në kundërshtim me dispozitat ligjore zgjedhore, duke shfrytëzuar kështu burimet dhe institucionet publike shtetërore për qëllime elektorale. Më tej në ankesë pretendohet se Kandidatja për deputete, Serbeze Kabashi Muçaj, me qëllim të përfitimit të votave dhe promovimit të numrit me të cilin shfrytëzohen kundërligjshëm hapësirat e institucioneve publike (se ka larguar vetëm në instagram), ku me këtë veprim janë shkelur dispozitat ligjore të nenit 36 paragrafi i LZP-së.

Si provë ka bashkangjitur fotografi dhe video në link:

https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=29161681426764125&id=100000469639478

Në përgjigjen në ankesë të datës 09.02.2025, theksohet, pretendimi se Subjekti Politik LDK dhe kandidatja, Serbeze Kabashi Muçaj, ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, konsiderojnë se video e realizuar në QKMF Istog e njëjta është gjykuar për këtë çështje (res judicata) dhe ka marr gjobën, andaj konsiderojmë se kjo duhet hedhur poshtë, si dhe një video e tillë është fshirë nga rrjeti social facebook që herët, andaj konsiderojnë se kjo ankesë duhet të hedhet poshtë

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, se përkundër vendimit të PZAP-it postimi i kandidates për deputete të subjektit Politik LDK Serbeze Kabashi Muçaj, është ende aktive, Paneli thekson se pretendimet e parashtruara në ankesën nga subjekti politik LVV janë të pabazuara, kjo pasi që nuk janë prezantuar prova që tregojnë se ende ekzistojnë postimet për të cilat pala ankuese pretendon, ndërsa nga hetimi që është bërë nga PZAP-i nuk rezulton se të njëjtat postime janë ende aktive në rrjetet sociale për të cilat pretendohet.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës si dhe nga hetimi i ndërmarr nga PZAP-ja, nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tillë të njëjtat e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.440/2025, datë 10.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.